

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare e Kuvendit të Kosovës
Nr. 02-57-18-07
Prishtinë, më 27 dhe 31 korrik 2007
Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 72 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 12 korrikut 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, me kërkesë të Grupit Parlamentar të ORA-s;
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përkrahje materiale familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme;
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin;
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
7. Debat lidhur me ndërtimet ilegale kolektive nga Qeveria e Serbisë në Veriun e Mitrovicës;
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Ndërkohë, janë parashtruar edhe tri mocione për plotësim të rendit të ditës: a) Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar të debatohet lidhur me situatën e krijuar me rastin e djegies së pyjeve në territorin e Kosovës; b) Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis ka propozuar që në seancën e sotme të debatohet çështja e zjarreve në pyjet e Kosovës, dhe c) Komisioni për Siguri ka propozuar të shqyrtohet situata emergjente në vend dhe pas debatit Kuvendi të nxjerrë rekomandime.

Këto tri propozime kanë të bëjnë vetëm me një çështje dhe mund të formulohen vetëm në një pikë të rendit të ditës.

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së tha se pajtohet me propozimet shtesë që të formulohen një pikë e rendit të ditës dhe të shqyrtohet menjëherë pas pyetjeve parlamentare.

Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së tha se i mbështet propozimet shtesë për rendin e ditës.

Kryetari i hodhi në votim propozimet për amendamentimin e rendit të ditës. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër----- 0.

Kryetari konstatoi: Kuvendi miratoi rendin e ditës me propozimet shtesë të cekura më lart.

Deputeti Xhevat Bislimi propozoi që seanca e sotme t'i shtyjë punimet, me arsyetimin se sot në Junik vendoset monumenti - shtatorja e **Edmond Hoxhës**, njërit prej dëshmorëve të parë të UÇK-së, për t'ua mundësuar deputetëve të marrin pjesë në atë ceremoni.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e z. Bislimi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----25;
Kundër-----1.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i shtyn punimet për të martën, më 31 korrik 2007, në orën 10:00.

E martë, më 31 korrik 2007

Vazhdim i seancës

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i kuvendit të Kosovës, kurse i ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Të pranishëm ishin 75 deputetë.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 12 korrikut 2007

Hydajet Hyseni pati vërejtje në pikën e tetë të procesverbalit – Përfundimit lidhur me propozimin për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit.

Procesverbali i seancës plenare të 12 korrikut 2007 u miratua me vërejtjet e cekura më lart.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me vendosjen e shtatores së komandantit të UÇK-së, Adem Jashari, në Prishtinë.

Kryeministri **Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputetja Gjylnaze Syla i parashtoi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë për veprimet e Bordit të AKM-së lidhur me zbatimin e kontratave nga ana pronarëve të ndërmarrjeve të privatizuara për punësim dhe investime.

Ministri **Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetes Syla.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtoi dy pyetje ministrit të Pushtetit Lokal: a) lidhur me veprimet juridike të Ministrisë së Pushtetit Lokal që të ndikojë në drejtoritë kompetente të komunave për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve në sektorin privat, dhe b) Çka ka ndërmarrë Ministria e Pushtetit Lokal që pranë çdo kuvendi komunal të sigurojë funksionimin e zyrës së deputetëve?

Ministri **Haziri** iu përgjigj pyetjeve të deputetit Kelmendi.

Deputeti **Xhevat Bislimi** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, lidhur me dëmet që po u shkakton KEK-u qytetarëve të Kosovës, sidomos me imponimin e taksave për RTK-në dhe regjistrimin e automjeteve.

Kryeministri **Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Bislimi.

Deputetja **Hatixhe Hoxha** i parashtoi pyetje ministrit të Tregtisë dhe të Industrisë për veprimet e kësaj ministrie për t'i ndaluar importimet e metaleve me origjinë të dyshimtë?

Ministri **Dugolli** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputetja **Safete Hadërgjonaj** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me përdorimin e suficitit buxhetor, të këtij viti, në vlerë prej 114 milion €.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hadërgjonaj.

Deputeti **Fetah Berisha** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me mosprocedimin e Projektligjit për ish-kryetarin e Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Berisha.

Deputetja **Hatixhe Hoxha** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me lirimimin e ndërtesës së re të Fakultetit Ekonomik nga ana e Ministrisë së Tregtisë dhe të Industrisë dhe e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale.

Ministri **Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputeti **Emrush Xhemajli** i parashtoi pyetje ministrit të Drejtësisë lidhur me mosekzekutimin e lëndëve të përfunduara nëpër gjykatat e Kosovës.

Ministri **Jonuz Salihaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Mazllom Kumnova** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë lidhur me përgatitjet e kësaj ministrie për fillimin e vitit shkollor 2007/2008 për klasët e pesta.

Ministri **Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kumnova.

Deputetja **Sala Ahmetaj** i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me paraqitjen e njerëzve të armatosur dhe me uniforma, para disa ditësh, në fshatin Radishevë. A ka Qeveria të dhëna se kush mund të qëndrojë prapa këtyre grupeve të armatosura?

Kryeministri **Agim Çeku** tha se do të përgjigjet në seancën e radhës.

Koha e paraparë (50 minuta) për pyetje dhe përgjigje kaloi, për pyetjet e tjera të parashtrua përgjigjet mbetën për seancën e radhës.

3. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, z. Agim Çeku, me kërkesë të Grupit Parlamentar të ORA-s

Kryesuesi e ftoi parashtruesin e mocionit për interpelancë ta marrë fjalën.

Deputeti Nazim Jashari, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s:- I nderuari Kryeministër, në aspektin e politikës së jashtme e keni përkrahjen tonë maksimale, por për politikë të brendshme, përkundër respektit të madh ndaj jush, përkundër asaj që dëshirojmë të besojmë që ju nuk jeni pjesë e shkeljeve, e abuzimeve që kanë ndodhur me rastin e tenderit të telefonisë së dytë mobile, ne e kemi borxh, sepse jemi opozitë në Kuvend të Kosovës, t'i paraqesim shqetësimet tona dhe të qytetarëve të Kosovës dhe dëshirojmë të sqarohet se Grupi Parlamentar ORA nuk është pjesë e abuzimeve me tenderin e Telefonisë së Dytë Mobile. Ajo çka ka ndodhur me rastin e atij tenderi, bie krejtësisht ndesh me ligjin.

Është e nevojshme për t'ua tërhequr vëmendjen juve që ta nisni një hetim brenda institucioneve tuaja, sepse është dështuar në zbatimin e ligjit, zoti Kryeministër.

Ne i ngremë shqetësimet tona lidhur me procedimin e tenderit për Telefoninë e Dytë Mobile, sepse sipas dispozitës 3.4 të dokumentacionit të tenderit, i cili është përpiluar nga Ministria, jo nga ART-ja, për licencimin e operatorit të dytë të Telefonisë Mobile nuk është bërë konfiskimi i 16.2 milion €, që përbëjnë 20% të shumës së ofruar nga fituesi i parë i shpallur. Kjo ka qenë një kërkesë eksplicite e thënë në dokumentacionin e tenderit. Në Ligjin e prokurimit publik, dhe në Ligjin për menaxhimin e financave publike, neni 55.1 pika c) (ii) thuhet qartë: “ Paratë, të cilat janë sigurim i tenderit, do të konfiskohen në qoftë se

tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit para nënshkrimit të kontratës përkatëse”. Ka qenë një kusht recidiv që para nënshkrimit është dashur që bashkë me dokumentacionin e tenderit, parashtruesi i ofertës ta ketë një zarf, në të cilin e deponon një garanci bankare prej 20% të vlerës së ofertës. Vlera e ofertës ka qenë 81 milion euro, kurse 20% të kësaj shume bëjnë 16.2 milion euro.

Ka nevojë për hetim qeveritar. Në qoftë se nuk ka hetim qeveritar, ka nevojë për hetim parlamentar. Gjithsesi ka nevojë për hetim, sepse qytetarët e Kosovës janë privuar nga 16.2 milion €.

Prandaj, ne insistojmë që ju të ndërmerrni gjithçka që është në dorën tuaj, në mënyrë që të mos kapërceni me kaq lehtësi mbi shkelje të ligjit.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryeministri Agim Çeku – Në bazë të nenit 36 të Ligjit për telekomunikacion, nr. 2002/7, Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit obligohet për përgatitjen e dokumenteve të tenderit për operatorin e dytë të Telefonisë Mobile, ndërsa Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit është implementues i tenderit. Në bazë të këtij neni, u kam sugjeruar juve që në këtë interpelancë ta ftoni ART-në, si institucion i pavarur, i cili i jep llogari këtij Kuvendi.

Qeveria është garantuese e ligjit, por duhet të definohen përgjegjësit e drejtpërdrejtë për implementimin e ligjeve.

Pakon tenderuese për Telefoninë e Dytë Mobile e ka përgatitur kompania “Konsulente AB SCELAKON”, që është angazhuar nga Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit. Në bazë të kësaj pakoje tenderuese është bërë edhe ftesa për aplikimin e ofertuesve.

Pas afatit të aplikimit është formuar Komisioni vlerësues i përbërë nga dy përfaqësues të UNMIK-ut, dy përfaqësues të ART-së dhe një përfaqësues i Qeverisë. Gjithashtu, me insistimin tim si kryeministër, PSSP-ja me qëllim të rritjes së transparencës gjatë tërë procesit, është formuar edhe Komisioni Special i Mbikëqyrjes, po ashtu, i përbërë nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, të ART-së dhe të Qeverisë.

Në fund të procesit të vlerësimit, i cili nga ana e Komisionit Special Mbikëqyrës është vlerësuar në mënyrë unanime si proces i rregullt, është bërë rangimi i ofertave dhe në vlerësimin e përgjithshëm të pikave nga Komisioni vlerësues Kompania “Kosmocel” është vlerësuar si ofertë e preferuar.

Kompania me ofertë të preferuar ka dështuar të përmbushë obligimin e saj konform dispozitës në pakon tenderuese. Sipas pikave të vlerësimit, ofertues i preferuar shpallet ofertues i dytë me radhë. Në këtë rast ofertues i preferuar është shpallur kompania IPKONET -Telekom Sllovenia. Kjo i ka përmbushur kriteret në bazë të pikës 3.4, me të cilin ka bërë pagesën e premtuar në shumë prej 75 milionë €, në afat kohor prej dy javësh.

Nënshkrimi i kontratës është bërë nëpërmjet ART-së dhe kompanisë IPKONET - Telekom Sllovenia.

Prandaj, në këtë kontest mund të konkludojmë se nuk bëhet fjalë për shkeljet e nenit 55.1, pika c (ii) të Ligjit për prokurim publik 2003/17, për arsye se nuk ka pasur dhënie të kontratës së licencës kompanisë “Kosmocel”. Pra, në këtë rast pika. 3.4 e pakos tenderuese është zbatuar në mënyrë të rregullt.

Në bazë të pikës 3.4 ART-ja ia ka bllokuar garancinë bankare “Kosmocelit”. Këto mjete janë të bllokuara në ART. Në bazë të pikës 3.4 të pakos tenderuese, ART-ja i ka bllokuar këto mjete. Por, Ligji për prokurim, neni 55.1 thotë: “Garancia bankare i konfiskohet vetëm nëse pas dhënies së licencës dështon, ose tërhiqet”. Pra, e kemi një konflikt në mes të Ligjit për prokurim publik dhe pakos tenderuese. Ajo çka është faktike është se garancia bankare është bllokuar nga ART-ja.

I tërë dokumentacioni i tenderimit të telefonisë së dytë mobile është dorëzuar në polici dhe është duke u hetuar nga ana e Njësitit për Hetime dhe procedura është në vazhdim e sipër.

Në debat morën pjesë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylaj**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahir Yagcilar**, në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, **Vezira Emrush** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputetët: **Naser Osmani**, **Teuta Sahaqija**, **Nekibe Kelmendi**, **Zef Morina** dhe ministri **Qemajl Ahmeti**, diskutimet e të cilëve i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të interpelancës, deputeti **Nazim Jashari** kërkoi që të i tërë procesi i tenderimit të Telefonisë së Dytë Mobile të hetohet deri në fund edhe konform Kodit Penal, i cili sanksionon shkeljen ose krijimin e rrethanave për përfitime të paligjshme, për ndërmarrje publike, ose për persona privatë.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përkrahje materiale familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme

Kryetari e ftoi propozuesin ta arsyetojë këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, **z. Ibrahim Selmanaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim, ministri **Selmanaj** e arsyetoi qëllimin, objektivat, materien që e rregullon Projektligji për përkrahje materiale familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, pjesën përfundimtare, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ana e ministri **Selmanaj**, kryetari e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Naim Jerliu**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Flora Brovina**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Myrvete Dreshaj-Baliu**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati** dhe në emër të Grupit Parlamentar për Integritet, **Ferid Agani**, si deputetët: **Naxhije Doçi**, **Teuta Hadri-Ramadani**, **Gjylshene Berisha**, **Ilaz Pireva** dhe **Nekibe Kelmendi**, diskutimet e të cilëve i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund, ministri **Selmanaj** dha sqarime lidhur me vërejtjet e deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryetari** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për----- 63;

Kundër----- 7.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi në parim Projektligjin për përkrahje materiale familjarëve të fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Punë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale - Komision përgjegjës raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për letërnjoftimin

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Ai i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Siguri lidhur me Projektligjin për Letërnjoftimin.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6, 7,8, 9, 10, 11, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet 5 dhe 12.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;

Kundër----- 5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi Ligjin për letërnjoftimin.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje

Kryetari i informoi deputetët e Kuvendit lidhur me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji, si dhe për raportet e komisioneve kryesore dhe të Komisionit përgjegjës – raportues.

Kryetari i hodhi në votim , veç e veç, amendamentet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor lidhur me Projektligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 4, 5, 6, 7,8, 9, 10(a), 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 30, 31, 32, 33 dhe 34.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 25, 26, 27, 28 dhe 29.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet në tërësi. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----50;

Kundër----- 5.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, miratoi Ligjin për trajtimin e ndërtimeve pa leje.

7. Debat lidhur me ndërtimet ilegale të banesave kolektive, nga ana e Qeverisë së Serbisë, në Veriun e Mitrovicës

Kryetari e ftoi parashtruesin e mocionit ta marrë fjalën.

Ramadan Kelmendi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDD-së - Në lagjet veriore të Mitrovicës Qeveria e Serbisë po financon ndërtimin e gjashtë ndërtesave kolektive për vendosjen e jo familjarëve, por të ardhacakëve dhe të rojeve të urës. Qëllimi i kësaj strategjie hegjemoniste është për të forcuar vijën ndarëse në baza etnike mbi lumit Ibër, për të bërë presion të vazhdueshëm edhe mbi ata pak shqiptarë atje për t'i lëshuar vatrat e tyre, duke ju ofruar mundësi blerëse enorme. Për ta ndërruar tërësisht strukturën etnike të popullatës të veriut të Mitrovicës, pikërisht tani kur po paraqiten dilema dhe probleme për ardhmërinë e Kosovës dhe për statusin e saj final. Qeveria e Serbisë për çdo metër katror dhe hapësirë të banuar ofron çmime enorme vetëm për t'i nxitur shqiptarët për të ikur. Institucionet tona vendore dhe qendrore nuk kanë mundësi, në aspektin financiar, pjesërisht për t'i ndihmuar. Ende nuk kanë marrë asnjë veprim konkret për stimulimin e qëndrimit të mëtutjeshëm të tyre në shtëpitë dhe në trojet stërgjyshore. Ndërtimi i banesave kolektive serbe po bëhet pikërisht në Zonën e Sigurisë, e cila me të gjitha normat ndërkombëtare trajtohet si zonë e ndaluar për çdo lloj ndërtimi kolektiv dhe individual.

Ky ndërtim kolektiv është tipik i karakterit ilegal me prapavijë politike. Ky ndërtim u dedikohet vetëm serbëve. Në këtë moment është politikisht i dëmshëm dhe krijon provokime ndëretnike. Mund të nxisë konflikte, pasojat e të cilave ne nuk i dëshirojmë, por ato do të na kaplojnë të gjithëve sot ose nesër nëse nuk marrim masa urgjente, që janë në duart tona.

Ndërtimi kolektiv në Veriun e Mitrovicës nuk e ka pëlqimin e komunitetit shqiptar, boshnjak, rom, egjiptian, hashkalinj e të tjerë. Këtë e vërtetojnë edhe protestat e shumta demokratike dhe tolerante, por ato nuk dhanë rezultate, sepse hasën në vesh të shurdhët në të gjitha nivelet e organizimit të shoqërisë sonë, duke filluar nga pushteti lokal e deri te ai qendror. Ky ndërtim është në kundërshtim të plotë me Ligjin për ndërtim, 2004/15 dhe me Planin hapësinor të Kosovës.

I propozoj Kuvendit të Kosovës që t'i miratojë këto rekomandime:

1. Deri në zgjidhjen përfundimtare të statusit të qytetit të Mitrovicës të mos vendoset askush në ato banesa kolektive.
2. Të sigurohet dhe të garantohet lëvizja e lirë e të gjithë qytetarëve në veri-jug dhe jug-veri.

3. T'i mundësohet secilit qytetar, pa dallim etnie, të kthehet në pronën, në shtëpinë dhe në banesën e vet.
4. Të gjitha gjykatat e Kosovës nuk duhet të bëjnë transaksione pronësoro-juridike deri në plotfuqishmërinë e dokumentit të Ahtisarit, përkatësisht zgjidhjes përfundimtare të Kosovës.
5. Të bëhet regjistrimi i gjendjes faktike të popullatës, të pasurisë familjare sipas gjendjes dhe dokumentet para luftës për ta dëshmuar të vërtetën juridike dhe etnike të popullatës atje.
6. Të formohet një fond i veçantë, me të cilin do të stimulohet qëndrimi i mëtutjeshëm i banorëve, që kanë mbetur pak në Veriun e Mitrovicës.

Pastaj, kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta marrë fjalën.

Ministri Ardian Gjini – Kjo është një çështje e rëndësishme për Kosovën, posaçërisht për njerëzit që jetojnë dhe kanë jetuar atje. Shtruarja e problemit vetëm në aspektin e ndërtimeve ilegale, realisht ikën prej esencës së këtij problemi. Nëse do ta kishim tkurrur problemin dhe do të diskutonim vetëm për ndërtimet ilegale në Veri të Mitrovicës, atëherë do ta relativizonim problemin. Ne, si Ministri e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk kemi tentuar që ta sjellim dhe ta shndërrojmë këtë vetëm në ndërtimet ilegale, por që t'ju ndihmojmë juve si Kuvend i Kosovës, qoftë në krijimin e komisioneve, qoftë në marrjen e hapave të tjerë, në mënyrë që ky problem të trajtohet ashtu si është, e jo vetëm si problem i ndërtimeve ilegale. Ajo që ne e kemi gjetur në terren, përkundër vështirësive që të marrim informacione, është se në Lagjen e Boshnjakëve i kemi diku 6 objekte të ndërtuara me 120 banesa, 6 objekte kolektive, se i kemi 2 objekte të tjera me etazh P+4 dhe P+6 me 36 banesa, të cilat janë ndërtuar në lagjen “7 shtatori”. Ne e dimë se në Veri të Mitrovicës funksionon një sistem jo formal për Kosovën, jo legal paralel. Ne e dimë këtë. Atje ekziston një zyre e UNMIK-ut, e cila quhet Zyrë për Urbanizëm, që merret me çështje të urbanizmit atje.

Nëse shikohen ligjet që janë në fuqi sot, ose Rregulloren 2001/3, ato objekte janë ilegale. Dhe nëse i trajtojmë si ndërtime ilegale, atëherë është kompetencë e komunës së Mitrovicës që të merret drejtpërsëdrejti me to, përderisa nuk shkojnë në shkallë të dytë. Mirëpo, komuna e Mitrovicës e ka vështirë të merret drejtpërdrejt me atë që është duke ndodhur. Nuk dëshiroj ta shndërrojmë këtë debat në debat për ndërtimet ilegale për shkak se nuk është i tillë, është debat për diçka tjetër.

Opinione dhe sugjerime lidhur me ndërtimet ilegale në Veriun e Mitrovicës, nga ana e qeverisë së Serbisë, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ilmi Ahmeti**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK, **Hydajet Hyseni**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Gazmend Muhaxheri** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahir Yagcilar**, si dhe deputetët: **Zylfi Merxha**, **Emrush Xhemajli**, **Ibush Jonuzi**, **Sabri Hamiti**, **Remzije Nimani**, **Agim Krasniqi**, **Nexhat Rexha**, **Sala Berisha-Shala**, **Fetah Berisha**, **Nekibe Kelmendi**, **Flora Brovina**, **Mazllom Kumnova**, **Xhevat Bislimi**, **Besa Gaxheri**, **Mark Krasniqi** dhe **Ymer Halimi**, të cilat i janë bashkangjitur trasnkriptit.

Në fund të debatit, në emër të parashtruesit të mocionit, **Ramadan Kelmendi**, kërkoi që rekomandimet e paraqitura në fillim nga ai të harmonizohen nga kryetarët e grupeve parlamentare, në bazë të debatit të zhvilluar dhe Kuvendi t'i miratojë ato.

Kryetari konstatoi se nuk ka kuorum të nevojshëm për t'i votuar rekomandimet e parashtruesit të mocionit lidhur me ndërtimet ilegale në Veriun e Mitrovicë, nga ana e Qeverisë së Serbisë.

8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit të për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me propozimin e Prokurorisë Publike të Kosovës për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Në mungesë të kuorumit kjo pikë u shty për seancën e radhës.

9. Shqyrtimi i Informatës së Ministrisë së Punëve të Brendshme lidhur me djegien e pyjeve

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës ta marrë fjalën.

Ministri i Punëve të Brendshme, z. **Blerim Kuçi**, - tha duke pasur parasysh situatën që është krijuar me shfaqjen e zjarreve kohëve të fundit, në bazë të përgjegjësi që ka, sipas dispozitave pozitive, Qeveria e Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 20.07.2007 ka formuar Komisionin Ndërministror për Menaxhimin e Krizave, me rastin e fatkeqësisë natyrore të shfaqjes së zjarreve dhe në të njëjtën ditë ka nxjerr Urdhëresën Administrative nr. 2007/4 me të cilën urdhërohen komunat t'i formojnë nënshtabet nëpër komuna, si dhe t'i koordinojnë veprimet me institucionet e tjera relevante si: TMK-në, SHPK-në dhe KFOR-in për të parandaluar përhapjen e zjarreve.

Përkundër angazhimit maksimal të njësive në terren, temperaturat e larta kanë favorizuar përhapjen e vatrave të zjarrit dhe nga 31 lokacione të përfshira me zjarr, numri i lokacioneve të përfshira me zjarr shtohet në 71, kryesisht në viset malore dhe hamullore.

Në kuadër të angazhimeve shtesë për ta përballuar situatën, udhëheqjen e Komisionit Ndërministror për Menaxhimin e situatës e merr ministri i Punëve të Brendshme. Me propozim të ministrit, Qeveria miraton vendimin nr. 06-264 në përmjet të cilit urdhërohen shtabet komunale që në përputhje me gjendjen e krijuar në terren të mobilizojnë burime shtesë njerëzore.

Si rezultat i këtyre masave shtesë, me datën 25 numri i lokacioneve të përfshira nga zjarri nga 71 zvogëlohet në 31. Mirëpo, për shkak të terrenit të vështirë, njësitë tona e kanë pasur të pamundur të afrohen në afërsi të lokacioneve të zjarreve. Kemi kërkuar të sigurojmë aeroplanë dhe helikopterë për intervenim nga ajri, si e vetmja mundësi për intervenim adekuat në zonat e thella. Kërkesat ua kemi drejtuar Francës, Gjermanisë dhe Sllovenisë.

E para ndihmë na ka ofruar Qeveria sllovene, e cila përmes komandës së tyre ushtarake që gjendet në kuadër të KFOR-it, ka angazhuar një helikopter.

Si rezultat i angazhimit të njësive në terren, më datën 28 kemi pasur një gjendje relativisht të kënaqshme, duke reduktuar numrin e vatrave të zjarrit nga 71 në 24.

Për të përballuar situatën më lehtë kemi krijuar një Task Forcë, të përberë nga TMK-ja, zjarrfikësit dhe njësitë vullnetare, e cila në përbërje do të ketë rreth 200 efektiva.

Në kuadër të përpjekjeve tona jemi angazhuar dhe kemi vënë kontakt me shtetet përkatëse me qëllim të parandalimit të zjarreve në këto zona. Deri më tani kontakte kemi vendosur me Zyrën Ndërlidhëse të Republikës së Shqipërisë dhe jemi në procedurën e hartimit të një memorandumit për veprime të përbashkët.

Shërbimi Policor i Kosovës ka shtuar aktivitetin e vet në gjithë territorin e vendit në mënyrë që hetimet rreth ngjarjeve ku dyshohet se shkaktar i zjarrit ka qenë faktori njeri.

Situata e tanishme ka filluar të stabilizohet. Kemi pesë zjarre aktive nën kontroll, 14 zjarre pasive, që jemi duke i shuar.

Kryetari e ftoi parashtruesin e mocionit ta marrë fjalën.

Deputeti **Xhevat Bislimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, - tha zjarret në Kosovë pothuaj se çdo vit, po sidomos këtë vit, përbëjnë një kërcënim serioz edhe për sistemin ekologjik, për pyjet, për tokën edhe për shëndetin publik. Zjarre ka pasur edhe viteve të tjera, sivjet sigurisht më shumë. Qeveria në këtë drejtim nuk i ka kryer obligimet e veta. Nuk ka bërë fushatën e mjaftueshme për t'i ndërgjegjësuar njerëzit që të mos ndezin zjarre, të mos e ndotin ambientin, të mos e shkatërrojnë sistemin ekologjik. Kësaj vere situata është dramatike dhe të gjithë jemi të vetëdijshëm për këtë situatë.

Kam përshtypjen se këto zjarre sivjet në Kosovës sikur po orkestrohen, sikur po frymëzohen, po nxiten nga hijet e padukshme.

Kam vërejtje për Qeverinë edhe në prezantimin e numrit të zjarreve. Në komunën e Vitisë janë ndezur jo 70, por ndoshta 700 zjarre. Edhe në komunat e tjera numri i zjarreve është më madh, ngase nuk ka mbetur arë e korrur pa u djegur.

Me këtë çështje mendoj që duhet të merret edhe kleri dhe ta trajtojë nga aspekti fetar para besimtarëve të tyre. T'u thuhet se është mëkat që të digjet toka, të digjet mali, sepse aty digjen edhe miliona gjallesa.

Qeveria nuk duhet të pres që të digjet një sipërfaqe e madhe e pyjeve të Kosovës, të shkaktohet një dëm i pallogaritshëm ekologjik, një ndotje e pallogaritshme e ambientit, e pastaj të reagohet.

Naim Maloku, kryetar i Komisionit për Siguri, foli për veprimet e këtij komisioni që kishte pasur me organet përgjegjëse për menaxhimin e situatave emergjente.

Në vazhdim ai i vlerësoi se veprimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të Departamentit për Menaxhimin e Emergjencave, të Shërbimit Policor të Kosovës dhe të Trupave Mbrojtëse të Kosovës **kanë qenë në nivel të duhur**, konform mjeteve dhe efektivave që i kanë në dispozicion.

Komisioni Parlamentar për Siguri do të organizojë një dëgjim publik me të gjithë segmentet që janë marrë me situatën e krijuar nga zjarret. Në bazë të raportit dhe të gjitha informatave që i kemi dhe vlerësimeve që do t'i bëjmë, do t'i drejtohem Kuvendit me rekomandimet e duhura.

Alush Gashi, kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së,- tha se e mirëpret raportin e ministrit të Punëve të Brendshme, që është një raport i përgatitur me kohë, i detajuar dhe shumë profesional.

Është hera e parë që Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës të punojë kaq intensivisht, me qytetarët e Kosovës, për parandalimin e zjarreve.

Bashkëpunimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme me KFOR-in, me TMK-në, me zyrat e ndërlidhjes dhe me shtetet në veçanti, kanë dhënë rezultate të mira.

Duhet kërkuar nga Ministria e Ekonomisë dhe e Financave që për buxhetin e vitit 2008 zjarrfikësve të Kosovës, njësisë për emergjencë në TMK, zyrave në nivelin komunal t'ju sigurohen pajisje adekuate për t'u përballur me situatat eventuale.

Ne do t'i japim mbështetje të plotë Qeveris që në vitet e ardhshme të jemi shumë më aktiv në raste të emergjencës.

Opinione dhe sugjerime lidhur me situatën e krijuar nga zjarret në Kosovës dhanë edhe këta deputetë: **Safete Hadërgjonaj, Nait Hasani, Mazllom Kumnova, Ramadan Kelmendi, Hydajet Hyseni, Xhelal Canziba dhe Nurishahe Hulaj**, të cilat i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 19: 55 minuta.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Kolë Berisha

E hartoi

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale